



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-1097/1 i datës 11.02.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi për veprim kompetent t'i përcillet Inspektoratit Shtetëror Administrativ të RMV-së.

Lënda me numër 12-1097 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1097/1 të datës 11.02.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Në denoncim, parashtruesi shpreh pakënaqësi me mënyrën e kryerjes së provimit modular nga zyrtarët në /// të RMV-së dhe në lidhje me shpalljen publike Nr. publikuar në vitin // /, për nevojat e ///. Parashtruesi vë në dukje veçanërisht se një kandidat gjatë dhënies së provimit i është lejuar përdorimi i telefonit, ndërsa regjistrimi i provimit nuk u inçizua. Provimi u mbajtë në vitin// duke filluar nga // në orën// /. Parashtruesi dyshon se një nga kandidatët nuk iu përgjigj saktësisht një pyetjeje të vetme dhe Komisioni i Zbatimit të Provimeve i shënoi përgjigjet e tij me // pikë, pa dhënë një vështrim në bllokun e provimeve. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. në shtojcë të denoncimit u dorëzua edhe xhirim ekrani nga uebsajti i Agjencisë së Administratës së RMV-së.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent për shqyrtimin e pretendimeve në denoncim është Inspektorati Administrativ Shtetëror i RMV-së, për këtë arsye KSHPK-ja e konsideroi të nevojshme t'ia përcjellë kërkesën e parashtruesit këtij autoriteti për kujdes të duhur.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: N.B.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

